


Sundimi i ligjit në pikëpamje të pranimit në BE

— dokument tremujor —

janar – mars 2022



Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup



Ky projekt finansohet nga Bashkimi Evropian



Sundimi i ligjit në pikëpamje të pranimit në BE

Dokument tremujor janar – mars 2022

Botues:

Instituti për politikë evropiane - Shkup

Për botuesin:

Dr. Simonida Kacarska

Redaktorët:

Dr. Simonida Kacarska
Dr. Ardita Abazi Imeri

Autorë:

Dr. Ardita Abazi Imeri
Angela Delevska
Angel Mojsovski
Iva Conevska Vangelova

Përkthim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:

Blerina Starova Zlatku

Dizajn grafik:

Relativ

2022, Shkup

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Ndërtojmë urë për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i së drejtës në drejtim të aderimit në BE", i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe assesi nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Ky dokument përmbledh zhvillimet kryesore në lidhje me sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut në pikëpamje të pranimit në BE për periudhën janar – mars 2022. Ai përfshin mbikqyrjen e bazave të hyrjes në BE, duke përfshirë zhvillimet kryesore në funksionimin e institucioneve demokratike, reformën e administratës publike dhe kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.¹

Zhvillimet kryesore

- » Komisioni Parlamentar për Sistemin Politik dhe Marrëdhëniet ndërmjet Bashkësive ka filluar diskutimin e Projekt Ligjit mbi Ndryshimet e Kodit Zgjedhor, me një propozim për një model proporcional, pa një prag zgjedhor, me modelin D 'hondt të shpërndarjes së mandateve ku shteti do të ishte një njësi zgjedhore.
- » Të dhënat nga regjistrimi u botuan në fund të marsit 2022, duke treguar se popullsia është ulur me rreth 10%.
- » Me zgjedhjen e Qeverisë së re dhe emërimin e ministrit të ri të drejtësisë, u paralajmërua hartimi i Strategjisë së re Gjyqësore 2023-2027. U caktua një Zëvendëskryeministër (ZKM) i ri për qeverisjen e mirë, duke marrë një pozicion që më parë ishte titulluar si ZKM për Luftën kundër Korrupsionit dhe Krimin, Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Burimeve Njerëzore.
- » Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri mbi ndërmjetësimin nën sloganin “Ka një zgjidhje”, u paralajmërua një fushatë për të nxitur ndërmjetësimin si një mënyrë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe u përcaktuan afate për miratimin e akteve nënligjore, së bashku me emërimin e Koordinatorit Kombëtar të Ndërmjetësimit dhe anëtarëve të tij. Megjithatë, procedura e përzgjedhjes nuk ka filluar ende.
- » Bordi i Shoqatës së Gjyqtarëve miratoi një Strategji për përmirësimin e statusit material të gjyqtarëve 2022-2024 dhe formoi një grup pune që do të përgatisë kërkesa të reja për institucionet me afate specifike për zbatim.
- » Maqedonia e Veriut u rendit e 87-ta në botë me 39 pikë indeksi, ndërsa në vitin e mëparshëm ishte në vendin e 111-të me 35 pikë indeksi në Indeksin e fundit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International, duke treguar përparim për shkak të ndjekjes penale të korrupsionit të nivelit të lartë dhe forcimit të organeve të mbikëqyrjes.
- » Në mënyrë të veçantë, Qeveria ka mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të regjistruar në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë të lirohen nga pagesa. Përveç kësaj, personat me statusin e fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror, prindërit e papunë të fëmijëve dhe personat me statusin e invalidëve të luftës gjithashtu përjashtohen nga bashkëpagesa e shkollimit.
- » Qeveria tërhoqi Projektligjin për Ndryshimin e Ligjit për Gjendjen Civile, me shpjegimin se ligji duhet të finalizohet.
- » U miratua Strategjia për Përfshirjen e Romëve 2022-2030.

¹ Në rastet kur janë dërguar kërkesa për informacion publik, periudha e raportimit mund të jetë më e shkurtër. Raste të tilla vërehen qartë në tekstin e përmbledhjes.



Lista e shkurtesave

AGJPP	Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë
PTHP	Prokuroria Themelore Publike
PTHP PKOK	Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
KVP	Kornizës së Vlerësimit të Përbashkët
KÇZE	Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve
KPMD	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
SMD	Sistemi i Menaxhimit të Dokumenteve
KE	Komisioni Evropian
MBNJ	Menaxhimi i burimeve njerëzore
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
ENER	Regjistri Elektronik Kombëtar i Rregulloreve
BE	Bashkimi Evropian
LRI	Laboratori i Raportimit Investigativ
LGBTI	Personat lezbike, homoseksualë, biseksualë, trans dhe interseksualë
LMDHP	Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
RAP	Reforma në Administratën Publike
PDC	Zhvillimi dhe koordinimi i politikave
AMDHP	Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
ZPP	Zyra e Prokurorit Publik
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
OSH	Ofrimi i shërbimit
ISHA	Inspektorati Shtetëror i Arsimit
SIGMA	Mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe të menaxhimit
PSP	Prokuroria Publike për Ndjekjen e Veprave Penale në lidhje me dhe që dalin nga përmbajtja e përgjimit të paligjshëm të komunikimeve (Prokuroria Speciale Publike)
VMRO-DPMNE	Organizata e brendshme revolucionare maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas



Përmbajtja

Funksionimi i institucioneve demokratike	6
Zgjedhjet	7
Kuvendi	8
Qeverisja	9
Shoqëria civile	10
Mbikëqyrja civile e sektorit të sigurisë/zbulimit	11
Reforma e Administratës Publike	12
Kapitulli 23	14
Funksionimi i gjyqësorit	15
Dokumente strategjike.....	15
Organet drejtuese	15
Pavarësia dhe paanshmëria	15
Llogaridhënia	16
Profesionalizmi dhe kompetenca	17
Cilësia e drejtësisë	17
Efikasiteti	18
Lufta kundër korrupsionit	19
Kuai institutional	19
Kuai ligjor.....	21
Të drejtat themelore	21
Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	21
Avokati i Popullit.....	21
Objektet e burgut dhe paraburgimit	22
Mbrojtja e të dhënave personale.....	22
Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë	23
Liria e shprehjes	24
Grupe të prekshme dhe parimi i mosdiskriminimit	24
Gjinia	25
Gjhuha e urrejtjes.....	26
LGBTI +	26
Romët.....	27

Funksionimi
i institucioneve
demokratike



Zgjedhjet

Gjatë periudhës raportuese, u zhvilluan diskutime mbi temën e reformës së kodit zgjedhor si përgjigje ndaj kërkesave të partive të vogla politike të përfaqësuara në parlament² për futjen e ndryshimeve në kodin zgjedhor, më specifiku që vendi të jetë një njësi zgjedhore, me një model zgjedhor proporcional dhe pa prag të daljes.³ Më parë këtë vit, deputetët e pesë partive të vogla në koalicionin qeverisës ofruan mbështetje të mëtejshme të kushtëzuar për qeverinë e re me amendamente të kodit zgjedhor me afat brenda tre muajve.⁴

Një vëzhgim i kohëve të fundit i pikëpamjeve të partive politike dhe qytetarëve mbi sistemin me një njësi “tregon se shumica e partive politike janë dakord me futjen e një njësie zgjedhore (me përjashtim të bllokut të partive shqiptare).”⁵ Qytetarët mendojnë të njëjtën gjë, por ata ende kanë qëndrime të forta negative dhe janë të zhgënjyer ndaj partive politike në lidhje me mënyrën se si partitë përfaqësojnë interesat e qytetarëve.⁶

Deri në fund të marsit, Komisioni për Sistemin Politik dhe Marrëdhëniet ndërmjet Bashkësive mbajti një seancë për Projekt-ligjin për Ndryshimet në Kodin Zgjedhor⁷ ku anëtarët e komisionit mbështetën fazën e parë të propozimit për një model proporcional, pa një prag zgjedhor, me modelin D “hondt të shpërndarjes së mandateve ku shteti do të ishte një njësi zgjedhore.”⁸

2 “Demokratski Sojuz: Reforma radikale e rregullave zgjedhore (Демократски Сојуз: Коренити реформи на изборните правила),” Faqja zyrtare e internetit e partisë politike Demokratski Sojuz, 29 janar 2022, shorturl.at/rOPRV.

3 “A do të sjellë radikalë dhe inflacion të klientelizmit ndryshimi i modelit zgjedhor?! (Промената на изборниот модел ќе донесе радикали во парламентот и инфлација на клиентелизам?!)” Deutsche Welle-North Macedonia, 21 janar 2022, <https://bit.ly/35qNFAV>.

4 “Pesë Partitë kushtëzojnë mbështetjen e tyre për Qeverinë (Пет партии ја условија поддрshkata за Владата),” Deutsche Welle 14 janar 2022, <https://bit.ly/3xdbpUr>.

5 Zlatko Atanasov et al., “Sistemi zgjedhore në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Si të sigurohet përfaqësim i barabartë dhe i drejtë në Parlament (Изборниот систем на Република Северна Македонија: Како да се обезбеди рамноправна и фер застapеност во Собранието)” (National Democratic Institute (NDI), shkurt 2022), <https://bit.ly/3tM7TgC>.

6 Ibid.

7 “Seanca nr. 39 e Komisionit për Sistemin Politik dhe Marrëdhëniet ndërmjet Bashkësive e caktuar për 22 mars 2022 në orën 10:00 (Седница бр. 39 на Комисија за политички систем и односи меѓу заедниците, закажана за 22.03.2022 година во 10:00 часот),” Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3J85Ysj>.

8 Ibid.

Kuvendi

Pikat kryesore të diskutimit në Kuvend u përqendruan rreth heqjes së Qeverisë Przhino, apanazhit dhe pagës minimale. Propozimi i VMRO-DPMNE-së për shfuqizimin e Marrëveshjes së Përzghinos për Qeverinë nuk u pranua nga shumica e deputetëve (32 votuan për; 55 ishin kundër).⁹ Kërkesa për kundërshtimin e kësaj marrëveshjeje erdhi nga partia më e madhe e opozitës në parlament dhe në vend, VMRO- DPMNE. Kërkesa për shfuqizimin e apanazhit të deputetëve u kundërshtua gjithashtu. Projekt- ligji u propozua nga një nga partitë më të vogla të opozitës në parlament¹⁰ dhe vetëm 16 deputetë votuan për të shfuqizuar apanazhin.¹¹ Sipas ligjit mbi pagën minimale, parlamenti pranoi njëzëri propozimin e qeverisë për të miratuar amendamentet në një procedurë të shkurtuar.¹²

Në lidhje me funksionimin e Kuvendit, u bllokuan disa komisione parlamentare si rezultat i zgjedhjeve lokale të vitit 2021.¹³ Disa deputetë janë transferuar nga Kuvendi në pushtetin vendor dhe ka patur një ndryshim të shpërndarjes së pushtetit brenda komisioneve. Kështu, përbërja e komisioneve nuk pasqyron situatën e re midis qeverisë dhe opozitës.¹⁴

Kjo ka rezultuar në një bllokadë të komisionit ligjvënës, komisioni që zgjedh gjykatësit në Gjykatën Kushtetuese. Për shkak të rrezikshmërisë që paraqet mungesa e vendeve të lira për gjyqtarë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese i dërgoi një kërkesë Kryetarit të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, duke kërkuar ndihmën e tij për të bërë presion që të mblidhet komisioni sa më shpejt të jetë e mundur për të zgjedhur gjyqtarët.¹⁵

Kryetari i Kuvendit, duke synuar zhblokimin e punës së Komisionit për Zgjedhje dhe Emërime propozoi shkarkimin e deputetit që nuk është më pjesë e koalicionit qeverisës. Në fillim të marsit 2022, u zhvillua një Seancë e Kuvendit në lidhje¹⁶ me propozimin e paraqitur nga Kryetari i Kuvendit për shkarkimin e deputetit, ku pas një debati tre ditor, me 61 vota për dhe pa praninë e opozitës, deputeti në fjalë u shkarkua¹⁷ si anëtar i KZE Ky vendim u dënua nga partia dhe ata njoftuan se “nuk do të jenë më konstruktivë”.¹⁸

9 Qeveria po ikë në mlynrë qyqare nga shfuqizimi i Qeverisë Przhino (Влада кукавички бега од укинување на Пржинската Влада),” Faqja zyrtare e Partisë Politike VMRO-DPMNE, 10 shkurt 2022, <https://bit.ly/35zp3pF>; Kërmov: Paraqitet Projektligji për Shfuqizimin e Apanazhit - Qeveria po përpiket të miratojë në mënyrë të parregullt Apartamentin (Крмов: Поднесен Предлог-Факон за укинување на апанажа – Влада се обидува неделовнички да усвои апанаж),” Faqja zyrtare e Partisë Politike Levica, 25 janar 2022, <https://bit.ly/3sPgLTk>.

10 Kërmov: Paraqitet Projektligji për Shfuqizimin e Apanazhit - Qeveria po përpiket të miratojë në mënyrë të parregullt Apartamentin (Крмов: Поднесен Предлог-Факон за укинување на апанажа – Влада се обидува неделовнички да усвои апанаж),” Faqja zyrtare e Partisë Politike Levica, 25 janar 2022, <https://bit.ly/3sPgLTk>.

11 “Deputetët pajtohen kur u puna ka të bëjë me xhepin e tyre. Vetëm 16 deputetë votuan kundër heqjes së Apanazhit (Пратениците сложни кога се работи за нивниот џеб. Само 16 пратеници гласаа против укинувањето на апанажата),” Plusinfo.Mk, 10 shkurt 2022, <https://bit.ly/3HTP1Rw>.

12 “Seanca nr. 62 e Parlamentit të R. Maqedonisë së Veriut, e caktuar për 10 shkurt 2022 në orën 11:00 (Седница бр. 62 на Собранието на Р. Северна Македонија, закажана за 10.02.2022 година во 11:00 часот),” Faqja zyrtare e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, , <https://bit.ly/3tDihHo>.

13 Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (Државна изборна комисија), “Zgjedhjet Lokale 2021 (Локални Избори 2021)”, tetor 31, 2021”11 mars 2021, <https://bit.ly/3lVqsVF>.

14 “Komisionet në Kuvend nuk punojnë prej muajsh, VMRO-DPMNE nuk sheh faj tek vetja (Комисии во Собранието не работат со месеци, ВМРО-ДПМНЕ не гледа кај себе вина),” Nezavisen.Mk, 14 shkurt 2022, <https://bit.ly/3pLGcTI>.

15 “Njoftimi: Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, Dobrilla Kacarska i dërgoi një letër Kryetarit të Kuvendit, Talat Xhaferi (Соопштение: Претседателката на Уставниот суд Добрила Кацарска испрати писмо до претседателот на Собранието, Талат Џафери),” Faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 7 shkurt, 2022, <http://ustavensud.mk/?p=21722>.

16 Seanca nr. 64 e Parlamentit të R. Maqedonisë së Veriut, e caktuar për 10 shkurt 2022 në orën 11:00 (Седница бр. 64 на Собранието на Р. Северна Македонија закажана на 01.03.2022 година во 11:00 часот),” Faqja zyrtare e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, , <https://bit.ly/3j2HaqZ>.

17 “Zendeli u shkarkuar me 61 vota, pa Opozitën (Зендели разрешен со 61 глас, без опозиција),” Fokus, mars 3, 2022, <https://bit.ly/3K6LPEK>.

18 “Pas shkarkimit të Zendelit, BESA kërcënohet: Nuk do të jemi më konstruktivë (По разрешувањето на Зендели БЕСА се закани: Нема да бидеме веќе конструктивни),” Fokus, 4 mars 2022, <https://bit.ly/3J50tKH>.

Kuvendi shqyrtoi Raportin e KE për vendin katër muaj pas publikimit. Ambasadori i BE-së Geer vuri në dukje se Kodi Zgjedhor duhet të rishikohet menjëherë, flamuri evropian nuk duhet të keqpërdoret dhe se duhet të ketë më pak përdorim të procedurës së shkurtuar, por gjithashtu Parlamenti duhet të forcojë rolin e tij dhe të angazhohet në dialog konstruktiv midis palëve.¹⁹

Qeverisja

Pati një ristrukturim brenda qeverisë,²⁰ me emërimin e disa ministrave të rinj: Gjithashtu u ristrukturua edhe Zyra e Zëvendëskryeministrit për Luftën kundër Korrupsionit duke u riemëruar si Zyra e Zëvendëskryeministrit për Politikë dhe Qeverisje të Mirë.²¹ Kryeministri i sapoemëruar ka njoftuar se portofoli i Zëvendëskryeministrit të ri nga 17 janar 2022 do të merret me qeverisjen e mirë, dhe gjithashtu do të mbulojë vendosjen e standardeve në institucionet, transferimin e njohurive dhe proceset e digjitalizimit në mënyrë që të reduktohen gabimet njerëzore. U vu në dukje se lufta kundër korrupsionit duhet të trajtohet nga Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Ministria e Brendshme (MD).

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International,²² vendi ka përmirësuar perceptimin e tij publik në luftën kundër korrupsionit dhe ka kaluar nga vendi i 111 në atë të 87 brenda një viti.²³ Vendi gjithashtu ka përmirësuar demokracinë pas daljes nga kategoria e “regjimeve hibride” sipas Economist Index of Democracy.²⁴ Në vitin 2021 Maqedonia u ngrit për pesë vende, nga 78 në vitin 2020 në vendin 73 në vitin 2021 dhe tani është në kategorinë e “demokracive me të meta”.

Dy dekada pas regjistrimit të fundit kombëtar, vendi ka kryer më së fundi një regjistrim të popullsisë dhe amvisërive.²⁵ Kjo veprimtari ka përfunduar në shtator 2021, ndërsa të dhënat janë publikuar në fund të marsit 2022. Një nga përfundimet kryesore që mund të nxirret nga regjistrimi është se popullsia është tkurrur me rreth 10%. Edhe pse qeveria pretendoi se ky proces ishte i suksesshëm, opozita ka ngritur shqetësime, duke thënë se për ata regjistrimi është i paplotë. Përkatësisht, VMRO DPMNE pretendon se 7.2% e popullsisë nuk janë regjistruar dhe se të dhënat janë marrë nga bazat e të dhënave.²⁶ Edhe bashkësitë jo-shumicë kanë shprehur pakënaqësinë e tyre me procesin.²⁷

19 “U prezantua Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2021 (Prezantuar në Izveštajot na Evropskata komisiya za 2021 godina),” Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 17 shkurt 2022, <https://bit.ly/3pOSpHs>.

20 “Seanca nr. 60 e Kuvendit të R. Maqedonisë së Veriut, e caktuar për 15.01.2022 në orën 11:00 (Sedница бр. 60 на Собранието на Р. Северна Македонија закажана на 15.01.2022 година во 11:00 часот),” Faqja zyrtare e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/35CVNy9>.

21 “Grkovska emërohet zëvendëskryeministre për qeverisje të mirë, jo për antikorupsion (Грковска именувана за вицепремиерка за добро владеење, а не за борба против корупцијата),” 360 Stepeni, 17 janar 2022, <https://bit.ly/3vPca5p>.

22 <https://www.transparency.org/en/>

23 Transparency International, “Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2021” (International, “Corruption Perception Index 2021”) (2021) < 2021 Corruption Perceptions Index- Explore the... - Transparency.org

24 The Economist Intelligence Unit, “Indeksi i Demokracisë 2021- Maqedonia e Veriut”, 10 shkurt 2022, 2022, <https://www.eiu.com/n/democracy-index-2021-less-than-half-the-world-lives-in-a-democracy/>.

25 Enti Shtetëror i Statistikave, “Popullsia totale rezidente e Republikës së Maqedonisë së Veriut është 1,836,713 banorë (Вкупното резидентно население на Република Северна Македонија изнесува 1 836 713 жители),” 30 mars 2022, <https://bit.ly/3uXf13D>.

26 “Miloshoski: Shifrat e regjistrimit të popullsisë janë dëshpëruese dhe operacioni është i paplotë (Милошоски: Бројките од пописот се поразителни, а операцијата некомплетна),” Faqja zyrtare e Partisë Politike VMRO-DPMNE, 30 mars 2022, <https://bit.ly/3x2P77G>.

27 “Partia Lëvizja Turke kërkon që Ligji për përdorimin e gjuhës të zbatohet siç duhet sipas rezultateve të regjistrimit (Partијата за движење на Турците бара Законот за употреба на јазиците да се имплементира соодветно според резултатите од пописот),” 360 Stepeni, 31 mars 2022, <https://bit.ly/3LA5VqG>.

Shoqëria civile

Deri në fund të dhjetorit 2021, qeveria kishte miratuar Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile, me Planin e Veprimit 2022-2024.²⁸ Strategjia ka identifikuar prioritetet e mëposhtme: përmirësimin e kuadrit ligjor për organizatat e shoqërisë civile; forcimin e kuadrit institucional dhe praktikave të bashkëpunimit midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, organeve të administratës shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile, krijimin e një kuadri tatimor që përmbush specifikat e punës së organizatave të shoqërisë civile dhe mundëson zhvillimin e tyre, si dhe përmirësimin e sistemit të financimit shtetëror të organizatave të shoqërisë civile.

Në sesionin e katërt²⁹ të Këshillit për bashkëpunim midis qeverisë dhe shoqërisë civile të mbajtur në shkurt 2022 u konstatua se mbështetja financiare për OSHC-të është hequr nga buxheti vjetor i shtetit. Sipas përfaqësuesit të qeverisë në këshill, arsyeja është se “për shkak të mendimit negativ të marrë nga Ministria e Financave, projekt-programi për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve për vitin 2022 është hequr nga Rendi i ditës i sesionit të dytë (tematik) të Kolegjit të Përgjithshëm të Sekretarëve të Shtetit”, i cili ndaloi procedurën qeveritare në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e tij. Gjithashtu u njoftua se “fondet në buxhetin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 nga pika 463-transferimet në organizatat joqeveritare janë të destinuara për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.” Nga OSHC-të u theksua se “kjo procedurë përbën një precedent dhe është e papranueshme pa u konsultuar me Këshillin për Bashkëpunim midis qeverisë dhe shoqërisë civile të alokohen fondet nga buxheti i qeverisë të destinuara për financimin e aktiviteteve të programit të shoqatave dhe fondacioneve për Kryqin e Kuq, i cili financohet çdo vit nga burime të tjera”.³⁰

Si përfundim, u mor vendimi që pas sesionit të Këshillit për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, Njësia për Bashkëpunim me Organizatat Joqeveritare e Sekretariatit të Përgjithshëm duhet të përgatisë dhe t’u paraqesë anëtarëve të këshillit një projekt-tekst të kërkesës për shqyrtim dhe miratim të programit të propozuar për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve për vitin 2022. Në seancën e fundit të Këshillit për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, u konkludua se Kryeministri duhet të dërgojë një letër këshillit që kjo çështje të vazhdojë ndërinstitucionalisht, pra të përpiqet të gjejë një zgjidhje të mundshme dhe të pranueshme për të dy palët.³¹ Ky vendim u vlerësua i papranueshëm nga organizatat e shoqërisë civile, kështu që këshilli vendosi t’i dërgojë një letër proteste Ministrisë së Financave dhe mbajti një konferencë shtypi.³²

28 “Strategjia e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile 2022-2024 (Strategjia na Владата на Република Северна Македонија за соработка со и развој на граѓанското општество 2022-2024)” (Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Sektori për Bashkëpunim me Organizatat Joqeveritare, 28 dhjetor 2021), <https://bit.ly/3tzL0g6>.

29 U mbajt më 10.02.2022 <https://www.nvosorabotka.gov.mk/?q=mk/node/696>

30 Këshilli për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, “PROCESVERBAL nga Sesioni i Katërt i Këshillit për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, i mbajtur më 10.02.2022 (3 А П И С Н И К од четвртата седница на Советот за соработка меѓу Владата и граѓанското општество, одржана на 10.02.2022 Година)”, 10 shkurt 2022, <https://bit.ly/3u2vR8y>.

31 “PROCESVERBALI nga Sesioni i Pestë i Këshillit për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, i mbajtur më 17 mars 2022 (3 А П И С Н И К од петтата седница на Советот за соработка меѓу Владата и граѓанското општество, одржана на 17.03.2022 година)” (Këshilli për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, mars 2022), <https://bit.ly/3uQyUh>.

32 “Këshilli për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile kërkon një konsolidim urgjent të Buxhetit të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë për Financimin e Shoqatave dhe Fondacioneve për vitin 2022”, Faqja zyrtare e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedoni, 24 mars 2022, <https://bit.ly/3j3F6yZ>.

Përveç kësaj, qeveria ka shkurtuar fondet për parandalimin e HIV në vend deri në 40%, të cilave organizatat e shoqërisë civile u janë përgjigjur duke bërë thirrje për të ndryshuar vendimin për të shkurtuar fondet.³³ Në të njëjtën kohë, organizatat e shoqërisë civile organizuan një protestë paqësore para Ministrisë së Shëndetësisë dhe njoftuan se do të ketë protesta më të mëdha nëse qeveria i përmbahet vendimit të saj.³⁴

Sulmet ndaj OJQ-ve ndodhën në fillim të vitit me një punonjës të një OJQ-je të sulmuar fizikisht si rezultat i lajmeve të rreme lidhur me përpjekjet e organizatës për të futur temën e “edukimit seksual gjithëpërfshirës” në arsimin fillor.³⁵ Lidhur me sulmin, Ministria e Punëve të Brendshme reagoi duke deklaruar se policia “po merr masa për të pastruar incidentin e djeshëm në organizatën joqeveritare, ku një punonjës u fye dhe u kërcënua.”³⁶ Reagoi edhe Presidenti i vendit, duke shprehur mbështetje për punonjësin si dhe për vetë organizatën.³⁷

Sa i përket qytetarëve dhe shoqërisë civile, sipas sondazheve, mbështetja për integrimin evropian është zvogëluar, kështu që ndikimi i perceptuar i BE-së në Maqedoninë e Veriut është zvogëluar në renditjen e saj më të ulët në vitet e fundit (nga 44.8% në 2019 në 9.5% në 2021). Vetëm disa maqedonas etnik e shohin BE-në si subjektin më me ndikim (7.8%). Për më tepër, perceptimi i qytetarëve për BE-në si aleati më i madh i vendit është ulur nga 43.2% në 2019 në 13.1% në 2021. Në të njëjtën kohë, përqindja e të anketuarve që zgjedhën të mos i përgjigjen kësaj pyetjeje është rritur nga 1.3% në 2020 në 17.6% në 2021.³⁸

Civilian oversight of the security/intelligence sector

Më 7 shkurt, Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Punës së Agjencisë së Sigurisë Kombëtare dhe Agjencisë së Zbulimit, kryesuar nga deputeti Ljupčo Prenxhov, inspektoi mjediset e Agjencisë së Sigurisë Kombëtare.³⁹

33 Këshilli për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile, “Këshilli për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Organizatave të Shoqërisë Civile kërkon ndryshimin e Vendimit që shkurton fondet për mbrojtjen nga HIV për vitin 2022 (Советот за соработка меѓу Владата и ГО бара промена на одлуката со која се кратат средствата за заштита од ХИВ за 2022 година)”, 22 mars 2022, <https://epi.org.mk/post/20618>.

34 Kanal 5, “OJQ-të protestojnë para Ministrisë së Shëndetësisë, duke kërkuar një rritje të buxhetit për HIV (Невладините на протест пред Министерството за здравство, бараат да се зголеми буџетот за ХИВ)”, 17 mars 2022, <https://bit.ly/3x2yr01>.

35 “HERA paralajmëron: Gënjeshtrat dhe fjalimi i urrejtes në internet janë shndërruar në një sulm dhe kërcënim për jetën për punonjësit e Hera-s (ХЕРА алармира: Лагите и говорот на омраза онлајн се претворија во напад и закана по живот за вработените во ХЕРА),” Faqja zyrtare e internetit të Hera-s- Shoqata për Arsimin dhe Kërkimin Shëndetësor, 14 janar 2022, <https://bit.ly/3Cm8sS4>.

36 “Ministria e Punëve të Brendshme: Ne po marrim masa kundër një personi që ka kërcënuar dhe fyer një punonjës në HERA (MBP: Преземаме мерки против лице што се заканувало и навредувало вработена во Хера),” Sloboden Pecat, 14 janar 2022, <https://bit.ly/3vSQSUr>.

37 Faqja zyrtare në Facebook e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut., <https://www.facebook.com/SPendarovski/posts/488452982645617>.

38 “Një rënie e madhe në perceptimin e qytetarëve për ndikimin e BE-së në Maqedoninë e Veriut (Голем пад во перцепцијата на граѓаните за влијанието на ЕУ во Северна Македонија),” Faqja zyrtare e Institutit për Demokraci Societas Civilis Shkup, 24 shkurt 2022, <https://bit.ly/3pN4Uml>.

39 “Vizitë Mbikëqyrëse në Komisionin për Mbikëqyrjen e Punës së ASK dhe AZ (Надзорна посета на Комисијата за надзор над работата на АНБ и АР),” Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 8 shkurt 2022, <https://bit.ly/3hMAaOv>.

Reforma e Administratës Publike

Me qeverinë e re⁴⁰ dhe me disa ministra të rinj të emëruar, pati gjithashtu një ndryshim në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA),⁴¹ institucioni kryesor për zbatimin e reformave të administratës publike. Ministri i ri vjen nga partia politike Alternativa, e cila arriti të negociojë tre poste ministore pasi rikonstruimi të qeverisë.⁴²

Pas dy vitesh, SIGMA publikoi raportin (për vitin 2021) nga monitorimi i administratës publike në Maqedoninë e Veriut.⁴³ Përfundimi kryesor është se vendi “ka bërë disa përparime në reformën e administratës publike (PAR) në vitet e fundit,”⁴⁴ me përmirësime në katër (nga gjashtë) fusha,⁴⁵ ndërsa dy të tjerat⁴⁶ “tregojnë një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2017.”

Në fushën e burimeve njerëzore dhe menaxhimit (MBN), KSHPK, në përputhje me kompetencën e përcaktuar ligjore të ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, nënshkroi Politikën e Integritetit, e cila duhet të motivojë institucionet e tjera për t'u përfshirë në politikat kundër korrupsionit. “Një program pilot për mentorimin e pesë institucioneve është në proces - Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës, Zyra Shtetërore e Auditimit, Këshilli i Inspektimit, Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacion Publik dhe KSHPK.”⁴⁷

Kur vjen puna te fusha e ofrimit të shërbimeve (OSH), procesi i dixhitalizimit është në krye të axhendës së ministrit të ri. Në një intervistë të fundit ai njoftoi për disa nga aktivitetet e programit të tij duke deklaruar se “aktivitetet specifike që pasojnë janë krijimi i 135 e-Shërbimeve të reja në Portalin Kombëtar për e-shërbime, krijimi i një Sistemi të Menaxhimit të Dokumenteve (SMD) me një numër institucioneve, duke përdorur identifikimin dixhital për 150,000 qytetarë.”⁴⁸

Që nga janari 2022, MSHIA ka qenë koordinatorë në fushën e menaxhimit të cilësisë dhe filloi me zbatimin e aktiviteteve të parashikuara për zbatimin e Kornizës së Përbashkët të Vlerësimit (modeli CAF), i cili është një model evropian për përmirësimin e organizatave publike përmes vetëvlerësimit.⁴⁹ Kjo do të thotë se MSHIA është institucioni i parë në vendin tonë që ka filluar me zbatimin e CAF 2020.

40 “Seanca nr. 60 e Kuvendit të R. Maqedonisë së Veriut, e caktuar më 15.01.2022 në orën 11:00 (Седница бр. 60 на Собранието на Р. Северна Македонија закажана на 15.01.2022 година во 11:00 часот),” Faqja zyrtare e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/35CVNy9>.

41 “Dorëzimi i pozitës së ministrit të Shoqërisë Informatike dhe Administratës”, Faqja zyrtare e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës, 17 janar 2022, <https://www.mioa.gov.mk/?q=en/node/3767>.

42 “Alternativa mori tre ministra dhe zëvendësministra, por në një Qeveri me një kryeministër të ri në vend të Zaevit (Алтернатива доби тројца министри и заменици-министри, но во влада со нов мандатар на местото на Заев)”, 5 dhjetor 2021, <https://bit.ly/36MnDJ3>.

43 SIGMA (Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit), “Raporti i Monitorimit të Parimeve të Administratës Publike të REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT”, (Monitoring Report the Principles of Public Administration REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA) nëntor 2021, <https://bit.ly/3sNY2aB>.

44 Ibid. faqe. 8

45 Ato fusha janë: Kuadri Strategjik për RAP; Llogaridhënia; Ofrimi i shërbimeve; dhe Menaxhimi i Financave Publike

46 Zhvillimi i politikave dhe koordinimi (ZHPK) dhe shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore (MRNJ) janë më të ulëtat në rajon.

47 “KSHPK, si udhëheqës në Sistemin e Integritetit, nënshkroi Politikën e Integritetit (ДКСК како предводник во системот на интегритет, ја потпиша Политиката на интегритет),” Faqja zyrtare e internetit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 11 shkurt 2022, <https://bit.ly/3MvUMsd>.

48 “Ministri Aliti për Frontline: Vazhdojmë me departizimin, fusim 135 e-shërbime të reja, identifikim digjital për 150,000 qytetarë (Министерот Алити за Фронлайн: Продолжуваме со департизација, воведуваме 135 нови е-услуги, дигитална идентификација за 150.000 граани),” Fronline.Mk, 8 shkurt 2022.

49 “MSHIA fillon e para me zbatimin e CAF 2020 në vendin tonë (МИОА прва кај нас започнува со имплементација на CAF 2020),” Faqja zyrtare e Ministrisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës, 27 janar 2022, <https://www.mioa.gov.mk/?q=mk/node/3780>.

Lidhur me fushën e menaxhimit të financave publike (MFP) me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të financave publike, Programi i Reformës Ekonomike 2022 – 2024 u miratua nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 28 janar, 2022.⁵⁰ Së bashku me Strategjinë për Zhvillimin e Tregut Financiar.⁵¹ Strategjia parasheh më shumë mundësi për financimin e projekteve për kompanitë, ofertën e rritur të instrumenteve të investimeve si edhe tërheqjen e investitorëve të huaj si qëllimet kryesore të strategjisë së zhvillimit të tregut financiar. Progresi në fushën e MFP është përshëndetur gjithashtu nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). FMN ka përshëndetur politikat fiskale, duke deklaruar se “ato kanë kontribuar në rimëkëmbjen e ekonomisë dhe ruajtjen e vendeve të punës.”⁵²

Në fillim të muajit shkurt, Auditori i Përgjithshëm pati një takim me Zëvendëskryeministrin për politikat e qeverisjes të mirë, dhe informoi Zëvendëskryeministrin se po përgatitet një propozim-ligj i ri në lidhje me auditimin shtetëror, “me zgjidhje të zbatuara për të gjitha të metat sistematike të zbuluara më parë, i cili kërkon të mundësojë pavarësinë operacionale dhe financiare të Zyrës së Auditimit Shtetëror.”⁵³

Në fund të marsit, MSHIA PUBLIKOI raportin vjetor për të punësuarit në sektorin publik për vitin 2021. Në kundërshtim me raportin e vitit të kaluar, numri i të punësuarve në sektorin publik është rritur pak me 905. Edhe pse ka patur një rritje të vogël në numrin e punonjësve të rinj, ka pasur një reduktim në numrin e punonjësve në institucionet shtetërore. Në vitin 2020 janë punësuar 15.945 persona dhe në vitin 2021 numri ka qenë 15.302, që është një rënie prej 643 vendesh pune.⁵⁴

Disa vjet pas fillimit të Projektit të Mbështetjes së Riorganizimit të Shtetit të mbështetur nga Bashkimi Evropian, u publikua Raporti i Sintezës për Riorganizimin e Shtetit. Raporti synon të optimizojë kuadrin institucional, të përmirësojë ofrimin e shërbimeve publike dhe të forcojë etikën, integritetin, transparencën dhe llogaridhënien e administratës publike me qëllim riorganizimin dhe optimizimin e kuadrit institucional, eliminimin e mbivendosjes së kompetencave dhe garantimin e linjave efektive të llogaridhënies.⁵⁵

50 “Programi i Reformës Ekonomike 2022- 2024 (Програма на економски реформи 2022- 2024),” Faqja zyrtare e Ministrisë së Financave, <https://bit.ly/3HUrY9t>

51 “MF: Me Strategjinë e Zhvillimit të Tregut Financiar për Mundësitë Alternative të Financimit për Kompanitë, mundësi më të shumta investimesh për amvisëritë dhe investitorët e huaj (MF: Со Стратегијата за развој на финансискиот пазар до алтернативни можности за финансирање на компаниите, повеќе можности за инвестирање на домаќинствата и странски инвеститори),” Faqja Zyrtare e Ministrisë së Financave, 9 shkurt 2022. <https://bit.ly/3INRjDb>.

52 “FMN mirëpret politikat fiskale- ato kanë ndihmuar në nxitjen e ekonomisë dhe kursimin e vendeve të punës ((ММФ ги поздравува фискалните политики – истите придонесоа кон закрепнување на економијата и зачувување на работните места),” Faqja zyrtare e Ministrisë së Financave, 16 shkurt 2022, <https://bit.ly/3KojYEb>.

53 “Përpjekjet e Përbashkëta në Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit (Заеднички заложби во превенцијата и борбата против корупцијата),” Faqja zyrtare e Zyrës së Kontrollit të Shtetit, 10 shkurt 2022, <https://bit.ly/3Ks7LJH>.

54 “U prezantua Raporti për punonjësit në sektorin publik për vitin 2021 (Презентиран извештајот за вработените во јавниот сектор за 2021 година),” Faqja zyrtare e Ministrisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës, 31 mars 2022, <https://bit.ly/3qXlBwb>.

55 Dace Gruberte – horizontal functional analysis, Aleksandrs Antonovs – state reorganisation, and Gunter Kube- visualisation, “Support to State Reorganisation: Synthesis Report on State Reorganisation Skopje, Republic of North Macedonia,” 3 nëntor 2021, <https://bit.ly/3j5dY2K>.

Kapitulli 23



Funksionimi i gjyqësorit

Dokumente strategjike

Me zgjedhjen e Qeverisë së re⁵⁶ dhe emërimin e ministrit të ri të drejtësisë, u paralajmërua hartimi i Strategjisë së re Gjyqësore 2023-2027.⁵⁷ Lidhur me këtë, ministri kishte dy takime me organizatat e shoqërisë civile.⁵⁸

Më 31 mars 2022, u mbajt seanca e Këshillit për Reforma në Sektorin Gjyqësor⁵⁹ në të cilën u miratua raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor 2017-2022 për vitin 2021.⁶⁰ Gjithashtu, u shqyrtuan aktivitetet për digjitalizimin në gjyqësor, u prezantua Ligji i ri për ekspertizë dhe u ndanë informacione për hartimin e Kodit Civil.⁶¹

Organet drejtuese

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë rregullisht publikojnë njoftime në ueb faqet e tyre përkatëse.⁶²

Kushtet hapësinore të Këshillit të Prokurorëve Publikë duhet të përmirësohen dhe të jenë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.⁶³

Në mars 2022, Këshilli Gjyqësor publikoi një njoftim për një sinjalizues të autorizuar, si dhe një procedurë për marrjen e raporteve të sinjalizuesit.⁶⁴

Pavarësia dhe paanshmëria

Bordi i Shoqatës së Gjyqtarëve miratoi një Strategji për përmirësimin e statusit material të gjyqtarëve 2022-2024 dhe formoi një grup pune që do të përgatisë kërkesa të reja për institucionet me afate specifike për zbatim.⁶⁵ Pavarësisht se marrëveshja është bërë në qershor 2021 midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Shoqatës së Gjyqtarëve për një rritje graduale të pagave të gjyqtarëve me 15%, me një rritje prej 10% të planifikuar për vitin e kaluar,⁶⁶ kjo rritje ende mbetet për t'u zbatuar nga Qeveria.⁶⁷

56 Kuvendi zgjodhi Qeverinë e re, Kovačevski është kryeministër (Собранието ја избра новата Влада, Ковачевски е премиер), Radio Evropa e Lirë, 16 janar 2022, <https://bit.ly/3x6vFqR>.

57 Tupançeski shpalli një Strategji të re për Gjyqësorin 2023-2027 në një takim me Gere (Нова Стратегија за правосудството 2023-2027 најавил Тупанчески на средба со Гир), 360 Stepeni, 9 shkurt 2022, <https://bit.ly/36VQg6D>.

58 Në shkurt u mbajt një takim me përfaqësues nga Instituti i Politikave Evropiane, ndërsa në mars u mbajt një takim pune me përfaqësues të Grupit Blueprint për Reformën Gjyqësore.

59 'Ftesë për sesionin online të Këshillit të Reformës së Sektorit Gjyqësor, 31.03.2022 (Покана за онлајн седницата на Советот за реформа на правосуден сектор, 31.03.2022)', mars 2022.

60 Ministria e Drejtësisë, "Vetëm përmes punës së përbashkët dhe të përkushtuar mund të krijojmë një sistem gjyqësor të qëndrueshëm, efikas dhe, mbi të gjitha, të pavarur (Само со заедничка и посветена работа може да воспоставиме еден стабилен, ефикасен и првенствено независен правосуден систем)", 31 mars 2022, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6331>.

61 Ministria e Drejtësisë, "Vetëm përmes punës së përbashkët dhe të përkushtuar mund të krijojmë një sistem gjyqësor të qëndrueshëm, efikas dhe, mbi të gjitha, të pavarur (Само со заедничка и посветена работа може да воспоставиме еден стабилен, ефикасен и првенствено независен правосуден систем)", 31 mars 2022, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6331>.

62 Sipas monitorimit të faqeve të internetit të të dy Këshillave.

63 Grupi Blueprint për Reformat Gjyqësore, Konferenca "Avancimi i Reformave Gjyqësore - Drejt Rikthimit të Besimit të Qytetarëve në Sistemin Gjyqësor" (Aleksandar Palace - Shkup, 29 mars 2022).

64 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 'Dokumente të tjera, [shorturl.at/dfCN7](https://bit.ly/3KlITF5).

65 Ibid

66 'Pagat e gjyqtarëve do të rriten me 15% (Платите на судиите ќе се зголемат за 15 отсто)', Pravdiko, 14 qershor 2021, <https://bit.ly/3KlITF5>.

67 Mbledhja e Bordit të Shoqatës së Gjyqtarëve më 10 shkurt 2022,, <https://bit.ly/3sk7LW3>.

Si pjesë e planit për dixhitalizimin e gjyqësorit dhe Strategjisë për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në Gjyqësor për 2019-2024⁶⁸ u miratua rregullorja për shpërndarjen elektronike të rasteve përmes zyrave të prokurorisë.⁶⁹ Për më tepër, sallat e gjyqit të pesë gjykatave pilot⁷⁰ u pajisën me pajisje përkatëse IT.⁷¹ Lidhur me operacionalizimin e veprimtarive për ndërlidhjen dhe shkëmbimin e të dhënave midis institucioneve gjyqësore, u nënshkruan marrëveshje për shkëmbimin e të dhënave me institucionet shtetërore, të cilat kryejnë 50% të shkëmbimit të të dhënave në baza ditore.⁷²

Këshilli për Gjyqësor të Hapur u krijua më 30 mars 2022 dhe është një organ i përbërë nga një përfaqësues nga çdo shkallë gjyqësore dhe përfaqësues të Këshillit Gjyqësor, AGJPP si dhe përfaqësues të Shoqatës së Gjyqtarëve dhe Shoqatës së Administratës Gjyqësore dhe përfaqësues të katër shoqatave civile.⁷³

Sipas raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2021,⁷⁴ shumica e ankesave të pranuar janë në fushën e gjyqësorit (436 ankesa ose 16.3% e totalit të ankesave të pranuar).

Llogaridhënia

Në periudhën janar - shkurt të vitit 2022, Këshilli Gjyqësor nuk i ka shkarkuar gjykatësit dhe kryetarët e gjykatave,⁷⁵ ndërkaq tre prokurorë publik janë shkarkuar.⁷⁶

Ndryshe nga viti 2021, në periudhën Janar - shkurt 2022, janë ngritur tre procedura disiplinore. Në mars të vitit 2022, ZTHPP Shkup për shkak të dyshimit të arsyeshëm për një shkelje të rëndë disiplinore.⁷⁷

Në Këshillin e Prokurorëve Publikë në periudhën janar - shkurt të vitit 2022 janë paraqitur 39 ankesa nga qytetarët dhe subjektet juridike.⁷⁸

KSHPK ka hapur tre lëndë kundër një prokurori publik në ZPTHP në Gostivar. Në një nga rastet, KSHPK është duke hetuar nëse ka pasur korrupsion në zgjidhjen e një aksidenti trafiku me pasoja fatale.⁷⁹

68 'Strategjia për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit në Gjyqësor për vitin 2019-2024 (Strategjia e Rishikuar) (Стратегија за информатичко-комуникациска технологија во правосудството за 2019-2024 Година (Ревидирана Стратегија))' (Ministria e Drejtësisë, shkurt 2019), shorturl.at/mrvvB6.

69 'Rregullorja për mënyrën e shpërndarjes së lëndëve në Prokuroritë Publike përmes sistemit për shpërndarjen elektronike të lëndëve (Правилник за начинот на распределба на предметите во јавните обвинителства преку Системот за електронска распределба на предметите)', Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 31/2022.

70 Gjykata themelore e Kavadarit, Gjykata themelore Shtip, Gjykata themelore Strumicë, Gjykata themelore Penale dhe Gjykata themelore civile.

71 "Tupaçeski: Që nga sot, gjyqet online po bëhen një realitet për Gjyqësorin Maqedonas (Тупачески: Од денес онлајн судењата стануваат реалност и за македонското судство)", Faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 2 mars 2022, <https://bit.ly/3jw876R>.

72 "Tupaçeski: Angazhimi për një gjyqësor modern dhe efikas po jep ngadalë, por me siguri rezultate", Faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 10 mars 2022, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6320>.

73 Akademik.mk, 'Themelohet Këshilli për gjyqësi të hapur dhe nënshkruhet Deklarata për gjyqësi të hapur (Основан Советот за отворено судство и потпишана Декларацијата за Отворено судство)', 31 mars 2022, <https://akademik.mk/osnovan-sovetot-za-otvoreno-sudstvo-i-potpishana-deklaratsijata-za-otvoreno-sudstvo/>.

74 Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, 'Prezantimi i Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2021 (Презентација на Годишниот извештај на Народниот правобранител за 2021 Година)', shorturl.at/gmqHZ.

75 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Paraqitja e Informacionit Publik (Доставување на информации од јавен карактер)", 11 mars 2022.

76 Të dhënat për prokurorët publikë të shkarkuar për periudhën janar dhe shkurt u morën nga Këshilli i Prokurorëve Publikë me kërkesë për qasje të lirë në informacion. Shkarkimi i fundit i një prokurori publik në mars është treguar duke ndjekur faqen e internetit të Këshillit. Këshilli i Prokurorëve Publikë, 'Në seancën e djeshme të 50-të, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut mori vendimet e mëposhtme (На вчерашната 50-Ta Sедница, Советот на навните Обвинители на РСМ, ги донесе следните одлуки)', Mars 2022, <https://bit.ly/37mkkif>.

77 A1on, 'Prokurori Publik u largua nga posti, ka sjell rastet deri në parashkrim (Јавен обвинител отстранет од функција, доведувал предмети до застареност)', March 2022, <https://a1on.mk/macedonia/javen-obvinitel-otstranet-od-funkcijata-poradi-disciplinska-postapka-dovel-predmeti-do-zastaruvanje/>.

78 Këshilli i Prokurorëve Publikë, 'Dërgimi i Informacionit Publik (Доставување на информации од јавен карактер)', 17 mars 2022.'

79 telma.com.mk, 'Komisioni Antikorrupsion ka tre lëndë të hapura për prokurorin e Gostivarit Arsim Ademi (Антикоррупциската комисија има три отворени предмети за gostivarскиот обвинител Арсим Адеми)', 14 mars 2022, <https://bit.ly/3xbhaCa>.

Profesionalizmi dhe kompetenca

Më 17 mars 2022, Këshilli i Prokurorëve Publikë vendosi të zgjedhë pesë prokurorë publikë në ZPTHP për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin. Sesioni ishte i hapur që ndihmon në përmirësimin e transparencës dhe trajton vërejtjen nga raporti i fundit i KE për vendin.⁸⁰ Në seancë, Këshilli rizgjodhi prokurorët të cilët në janar të vitit 2018 aplikuan për pozita brenda ZPTHP PKOK.

Në periudhën janar - shkurt 2022, Këshilli Gjyqësor nuk zgjodhi gjykatësit apo kryetarët e gjykatave.⁸¹

Projekt-ligji i ri mbi Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë,⁸² i cili u miratua nga Qeveria në qershor të vitit 2021, është ende në procedurë parlamentare për shkak se ishte bllokuar nga VMRO-DPMNE me arsyetimin se projekt-ligji shkel procedurat dhe abuzon flamurin evropian. VMRO-DPMNE kishte kërkuar tërheqjen e tij.⁸³

Cilësia e drejtësisë

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Ndërmjetësim në janar 2022,⁸⁴ Ministria e Drejtësisë nën sloganin “Ekziston një zgjidhje” njoftoi për fillimin e një fushate për të promovuar ndërmjetësimin si një mënyrë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për përfitimet.⁸⁵

TAFati për miratimin e akteve nënligjore të Ligjit për Ndërmjetësim⁸⁶ së bashku me caktimin e Koordinatorit Kombëtar për Ndërmjetësim dhe anëtarëve të tij është tre muaj. Para publikimit të kësaj përmbledhjeje, koordinatori kombëtar nuk ishte emëruar dhe procedura për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nuk kishte filluar.

Megjithëse miratimi i një Ligji të ri mbi Procedurën Civile ishte një nga përparësitë e Komisionit Evropian,⁸⁷ ky ligj është ende në procedurë parlamentare.⁸⁸ Ndryshimet në Kodin Penal lidhur me Konventën e Stambollit janë gjithashtu në procedurë parlamentare.⁸⁹

Në periudhën në vijim, përveç përgatitjes së një kodi të ri penal, u njoftua për hartimin e kodit të ri civil në përputhje me Strategjinë Gjyqësore të tanishme.⁹⁰

80 Komisioni Evropian, ‘Raporti për Maqedoninë e Veriut 2021’, Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit (Strasburg, 19 tetor 2021), https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/north-macedonia-report-2021_en.

81 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ‘Paraqitja e informacionit publik (Доставување на информации од јавен карактер)’.

82 Kuvendi i R. Maqedonisë së Veriut, ‘Materialet- Projekt-ligji mbi Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë’ <[https://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialid="543628f3-2109-4bd5-8b99-22d543901888"](https://www.sobranie.mk/materialdetails.nspx?materialid=)>.</https:>

83 ‘Tensionim në Komisionin Parlamentar për Sistemin Politik, VMRO-DPMNE nuk lejon debat mbi projekt-ligjin për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë (Тензишно на собраниската Комисија за политички систем, VMRO-ДПМНЕ не дозволува расправа за предлог законот за Академија на судии и јавни обвинители)’, Telma TV, 9 shkurt 2022, <https://bit.ly/3hjlDt8..>

84 ‘Ligji për ndërmjetësim’, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 294/2022.

85 ‘Mariçiq’ shpall fushatën “Ka një zgjidhje”: Ndërmjetësimi është procedurë më e shpejtë dhe më ekonomike (Мариџиќ ја најави кампањата „Има Решение“: Медијацијата е побрза и поекономична постапка)’, Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 janar 2022, <https://vlada.mk/node/27370>.

86 Ligji për ndërmjetësim.

87 Komisioni Evropian, ‘Raporti i Maqedonisë së Veriut 2021’.

88 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, ‘Materiale (материјали)’, <https://bit.ly/3v2hK29>.

89 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ‘Materiale - Projekt-ligji që ndryshon kodin penal (материјали - предлог на Закон за изменување и дополнување на Кривичниот законик)’, <https://bit.ly/3xigcno>.

90 Ministria e Drejtësisë, ‘Vetëm nëpërmjet punës së përbashkët dhe të përkushtuar mund të vendosim një sistem gjyqësor të qëndrueshëm, efikas dhe mbi të gjitha të pavarur (Само со заедничка и посветена работа може да воспоставиме еден стабилен, ефикасен и првенствено независен правосуден систем.)’ shorturl.at/bvxMO.

